REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 942-961/20
Datë/Datum. 01.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Avdush Bajramaliu, *Eksperti shqyrtues i jashtëm*	*19.11.2020*	*30.11.2020*	Nr. i lëndës: 942-961/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2020, OE ". AL-BER"SHPK & VISAR KUÇI B.I. – Suharekë ka parashtruar ankesë me nr: **942-961/20**, kundër Njoftimit për dhëne të kontratës nga autoritetit kontraktues,Komuna e Mamushës ,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË-FAZA E PARË NDËRTIMI I VRAZHDËT**" me nr. të prokurimit: **659-20-5348-5-2-1**, me nr.te brendshme 659-20-026-521iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E MAMUSHËS
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë e hapur**,: **PUNË** vlera e parashikuar e kontratës: **191 266,00 €**
SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP**-së)
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues"AL-BER" SHPK.

Njoftimi për kontrate: 18.09.2020
Afati për dorëzimin e ofertës : 02.10.2020 ora 14:00
Njoftimi mbi Vendimin e AK-se 27.10.2020
Kërkesa për Rishqyrtim 02.11.2020
Përgjigjja ne kërkesën për rishqyrtim 09.11.2020
Ankesa ne OSHP. 16.11.2020

Pretendimet ankimore te OE,Ankues "AL-BER"SH.P.K. :

1. **Neni 7. i LPP-se Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.**
2. **Neni59 i LPP-së Vlerësimi i tenderit**
3. **Neni 3 i RRUOPP pika 3.12 Kërkesa për përdoruesin e sistemit te prokurimit elektronik**
4. **Neni 41 i RRUOPP Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve**

DSPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues VISAR KUÇI B.I.

Njoftimi për kontrate: 18.09.2020
Afati për dorëzimin e ofertës : 02.10.2020 ora 14:00
Njoftimi mbi Vendimin e AK-se 27.10.2020
Kërkesa për Rishqyrtim 01.11.2020
Përgjigjja ne kërkesën për rishqyrtim 09.11.2020

Ankesa ne OSHP.17.11.2020

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- **Neni 1 Qellimi**
- **NENI 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7 Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi**
- **Neni 59 Ekzaminimi Vleresimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
- **Neni 69 AftesiaTenike dhe ose Profesionale**
- **Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**
- **Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ per Prokurim Publik 86**

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet e OE-se ankuese
Pretendimet ankimore te OE-se ankuese

PRETENDIMET ANKIMORE të OE-së ankuese"AL-BER" SHPK.

Te nderuat

Sikur jeni ne dijeni ,ne kemi shprehur interesimin tone për pjesëmarrje ne tenderin ne fjalë,Pasi kemi pas njoftimin për kontratë,kemi përgatitur dokumentacionin ne menyr qe ti plotsojm kërkesat e paraqitura nga ana juaj ne dosjen e tenderit dhe Njoftim për Kontratë.

Me daten 02.10.2020 përmes platformës elektronike ,kemi dorezuar oferten tone

Pasi e keni publikuar Njoftimin për B58 Për dhënie te Kontratës,ne me datën 28.10.2020 ,kemi kerkeuar qasje ne dokumentacionin tenderik.Nga ana tyre,kemi marr dokumentacionin e grupit te Operatoreve ekonomik te cilën e keni shpërblyer me kontratë.Pas ekzaminimit te dokumentacionit te tyre ,kemi vërejtur se grup i O.E. Nuk është i pergjegjeshem sepse nuk e ka dorëzuar tenderin ne formën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues ne dosje te tenderit

Nga Formulari i paraqitjes se tenderit shihet qarte aplikimi ne te cilin grupi ka paraqitur formularin e tenderit vetëm ne emër te liderit te grupit "AAB CONSTRUCTION""SH.P.K."

Ndërsa ata ne njoftimin për dhënie te kontrates e ken cekur se shpërblehet me kontratë grupi i operatoreve ekonomik "AAB CONSTRUCTION""SH.P.K." NPSH."BAGERI" & "AL-GROUP" SH.P.K.

Ata si autoritet Kontraktues ne dosje te tenderit ken kerkuar qe ne rast te krijimit te grupit te gjitha anëtaret duhet te jene te regjistruar ne platformen elektornike KRPP-s dhe tenderi duhe te dorëzohet ne grupë,qe ne nënkupton qe tenderi te dorëzohet nga te gjithë anëtaret e grupit bashkërisht dhe jo vetem nga lideri i grupit. (SH.i h): Seksioni II. FLETA E TE DHENAVE TE TENDERIT (FTD Neni 11.1)

Platforma elektronike e KRPP-se e ka parapare mundësin e krijimit te grupit ne te cilën duhet te ceket te gjithë antaret dhe ta krijojn grupin ne sistem te e.-prokurimit,ne menyr qe grupi te pasqyrohet ne te gjitha dokumentet e tenderit.Gjate ekzaminimit te dokumentacionit te cilen e kemi pranuar nga ana e tyre ,shihet ne procesverbalin e hapjes se tenderit,se është dorëzuar vetëm nga lideri ndërsa ne raportin e vlerësimit dhe vendimin perdheni e ata kane cekur se shperblejn me kontratë Grupin e operatoreve ekonomik.

Gjate ekzaminimit te formularit te dorëzimit te tenderit ne kemi vërejtur edhe shkelje tjera te cilat jane bere nga ana e AK-se.Sikur shihet nga certifikata e biznesit ,: 'AAB CONSTRUCTION"SH.P.K. Kane ndryshuar te dhenat e biznesit (Nr.e biznesit dhe nr.fiskal) por ne platformen elektornike dhe nuk i ka paraqitur ndryshimet NENI 3 RROUP. 3.12 .Kërkesat për përdoruesit e sistemit te prokurimit elekotrronik,shprehimisht ka parapare qe :"Te

gjitha Operatoret Ekonomik qe jane te regjistruar dhe jane aktive ne platforme te prokurimit elektronik ,per çfardo ndryshimi te dheniave te biznesit ne Agjincion për regjistrim te bizneseve (ARBK),dhe ne Administratë Tatimore. (ATK) ,Qe per pasoj ka ndryshim/nderrim te mertimit dhe numrit te fiskal /biznesit jane te obliguar qe menjher vete T.I Perditsojn te dhenat ne platform te prokurimit elektornik.Perditesimin i te dhenave behet ne pajtim me Udhzimet e KRPP-së,n permejet tavolines ndihmse ose udhezezuesit te publikuar web faqe te prokurimit elektronik Nga ato qe i thane me lart,vijmë ne përfundim qe ata si autoritet kontraktues ,kane shpallur fitues nje tenderues i cili nuk i ka plotesuarkerkesat formale administrative.Duke vepruara keshtu kane shkelur njrin nga parimet kryesore te procedures se vlersimit sipas LPP-se te përcaktuar ne Nenin 41 i RRUOPP.

Gjate vlersimit te tenderit ata si AK.nuk e kenë marr parasysh kërkesën e tyre te cilën vete e kenë paraqitur ne dosje te tenderit qe ne rast te krijimit te grupit ,Tenderi te dorezohet ne grup

Ligji i prokurimit publik ne nenin 59 dhe RRUOPP.ne nenin 41 ka parapar qe AK,ekzaminimin dhe vlersimin dhe krahasimin e tenderëve te bej ne përshtatje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontratë.

Pra veprimi i tyre eshte ne kundërshtime dispozitat e cekura me lart andaj konsiderojm qe ata si AK.I ken shkelur keto dispozita gjate vlerësimit te tenderit.

Shpërblimi i një operatori te papergjegjeshem me kontrate paraqet favorizimin dhe ne te njejten kohe diskriminim për operatoret e pergjegjeshm,ndaj duke vepruar ne kete meny konsiderojm qe ken bere edhe shkelje te nenit 7 te LPP-se

Nga e tere ajo qe u tha me lart,vim ne perfundimin se ata si AK.Nuk e kana bere nje vlersim të drejt dhe te paanshem ,prandaj kërkoj qe menjëherë te pezulloni procedurën e prokurimit ,te ,ryshqyrtojn vendimine tyre per dhenie te kontratës duke e kthyer procesin ne rivlerësim dhe te na shpërbleni neve me kontratë si te vetmin Operatore Ekonomik te pergjgjeshm ne kete procedur te prokurimit..

PRETENDIMET ANKIMORE të OE-së ankuese "VISAR KUQI B.I.NTP."THESAR"

Arsyeja se Ne jemi elimiuuarngaky Projekt riga anae komisionitvlersues apoZPPeshte qecveofruarnganeperstafinapoIngjinjeratnukjantenenshkruarangavetiiinxhinieret.

Ne si kompani nuk pajtohemi me ete arsyetim te komisionit vlersues ku ne besojm qe nuk keni zbatuar si AK Ligjin /Neni 72 Dokuemntacioni dhe infmacioni shtese per te gjithe OE.

Ndersa perkompanit e tjera keni kërkuar sqarime shtes per ne jo mendojmë se jemi diskriminuar nga ana juaj si AK apo Komisioni Vlersues

Sqarimet ju kujtojm qe ne ofert kemi parasqitur stafin apo inxhinierin sipas kerkesave te FDT te dosjes se tenderit ku secili ing.eshte i paraqitur me diplom te noterizuarcv. Dhe Diploma janekopletnje Dokument e jo secili veq e vet ndarazi

Rregullat dhe Udhëzuesin Operative per Prokurim Publik 86 THOTË :

CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	NENI 69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund te vendos	Mund te kërkohen informata sqaruese	NENI 69

Nuk eshte respektuar ky Nen 72 Dokumentacioni dhe Infomracioni shtesë ku thote :

1.Kur informacioni apo dokuemntacioni qe duhet te dorezohet nga operatoret ekonomik eshte ose kurket te jete jo i plotë ose i gabuar ose kur mungojn dokumentet specifike ,autoritetet kontraktuese mund te kerkojn nga operatoret ekonomik qe te dorezojn .plotesojn ,sqarojn apo kompletojninfrormacionin apo dokumentacionin e duhur brenda nje afati te caktuar kohore,me kusht qe kerkesa e tille beher ne perputhj te plote me parimet e trajtimit te barabart dhe transparences.

2.Autoriteti kontraktues mund te ftoje operatoret ekonomik për te plotësuar apo te qartësoj ,certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te ketij ligji.

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE TE DOKUMENTET E STAFIT TE CILET I KEMI NE OFERTEN E DOREZUAR

. Neni 7 Barazia ne trajtim/ Jo –Diskriminimi

- Per OE I ELIMINUAR –ITACT SH.P.K.-Kane kërkuar sqarime shtesë ne çmimet e ofruara ne pozicionin e Paramases për çmimet jo normalisht te ulta. Nuk eshte pergjegjuer afateve te caktuara nga AK.
- Per OE FITUES –AAB CONSTRUCTION SH.P.K. –Skeni kërkuar sqarime shtese ne pozicionet e oferuara te paramases po thuaj se te gjitha pozicionet janë te njëjta janë me çmim Jo normalisht te ulta te OE i Eliminuar për këto pozicione ku ka pozicione dhe me çmime te njëjta ka pozicione me çmime me te ulta se OE,fitues se OE i Eliminuar.ne mendojmë se kete pike janë bere lëshime nga komisioni i vlerësimit dhe nuk jane trajtuar te thithe OE Njësoj ne procesin e vlerësimit kerkojm nga ju Si OSHP. Ta vlersoni apo kontrolloni keti pike pasi qe komisioni vlerësues dhe ZPP Nuk e kane vlersuar njejt te gjithë OE.
- RRUOPP 18.21 THOTË –Gjatë arsyetimit te çmimeve te cilet jane konsideruar si jo-normalisht te ulta nga Autoriteti Kontraktues ,siç është e rregulluar ne nenin 61 te LPP-se ,autoriteti kontraktues mund te merr parasysh si ekonomin e procesit te prodhimtarisë,zgjedhjes tenike dhe kushteve veçanërisht te favorshme qe janë ne dispozicion për tenderuesin.Elementet qe lidhen me mos pajtueshmërinë me rregullat për sigurinë ,kushtet e punës apo punësimit mund te merren parasysh për te refuzuar një tender jo-normalisht te ulet.

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.1.

- Formulari i tenderit apo Paramasa ku është e cekur ne fund te çdo paramane vendi dhe vula e OE per tuplotsuar apo vulosur Nënshkruar nga OE i mungon nënshkrimi dhe vula andaj kerkojm nga ju si OSHP ta shikoni me **kujdes** ketë gabim pasiqe komisioni vlerësues dhe ZPP nuk e kanë vlerësuar sipas ligjeve dhe rregullave te prokurimit.

Rregullatdhe Udhëzusi Operativ për Prokurimin Publik 86 THOTE

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e dorëzuar ne forme fizike)	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.2.

- Kushtet dhe kërkesat sipas FDT te kriteret 5.2

Operatoret t ekonomik pjesëmarrës *në këtë* tender janë të obliguar që të 'hartojnë planin dinamik për ekzekutim të kontratës sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.
-Plani dinamik nuk duhet të jetë më igjatë se 45 (Dyzete pesë) ditë pune nga data e marrjes së urdhërblerjës nga Autoriteti Kontraktues
Në rast te përmbushjes së këtij kushti O.E. do *i konsiderohet* si i papërgjegjshëm,oferta do ti refuzohet dhe do të qojë ne eliminimin e operatorit ekonomik.

- Plani Dinamik I ofruar nga OE i shpallur fitues nga Ak nuk I plotson kushtet siç është kërkesa nga Akte FDT te dosjesse *tenderi*

OE I rekomanduar si fitues ka ofruar plan dinamik po jo siç është te kerkesa e Dosjes se tenderit sepse ka ofuar plan dinamik me data nga data e fillimit te punimeve është cekur 02.10.2020 vendimi I shpallur fitues data 27.10.2020 qe I bije punimet kanë filluar deri ne shpalljen e vendimit për OE fitues qe I bije 25 ditë pune vetem kan përfunduar për te ndërsa I kanë mbetur prej ditës se sodit data 01.11.2020 (dita kurkemi berë kërkese për Rishqyrtim) deri ne datën qe e kanë paraparë me për fundu sipas planit dinamik edhe 15 dite kalendarike qe I bije te mos përputhet me data apo sipas kërkesës se dosjes se tenderit qe Plani Dinamik duhet me qen 45 ditë pune Ndërsa ne sot jemi ne datën 17/11/2020 sipas planit te ofruar nga OE I rekomanduar për kontratë ditët apo puna ka përfunduar sipas planit dinamik qe ka ofruar ky OE.

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE
SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.3

OE I rekomanduar si fitues nga AK ka ofruar çmime Jo Normalisht të Ulët ne Pozicionet PUNET E BETONIT DHE ARMATURES Pozicionet4.4.4.5:4.6:4.7:4.8:4.9: (POZICIONI 4.10(QMIMI m2 2217.96 x 0.10) si mundet te realizohet ky pozicion me çmimin e ofruar ne paramas nga OE . Fitues.)Pozicioni4.11:PUNETEIZOLIMITPozicioni5.1:
OE I cili ka qen me I lirë se OE i rekomanduar si fitues për te njëjtat pozicione ka pasur apo ZPP dhe komisioni vlerësues kanë kërkuar informata sqaruese për pozicionet e ofruar si qmime jonormalisht të ulta ndersa OE I rekomanduarsi fitues nuk janë kërkuara sqarim janë marrur apo vlerësuar këto pozicione mendoim sepse janë ç mime pothuajse te njëjta me OE te eliminuar cili ka qene me lire se OE.i rekomanduar si fitues.

18.20 Në përputhje me nenin 61 të LPP, Thotë:
autoritetetkontraktuesemundtërefuzojnëtenderitjonormalishttëultëpërshkak,tëmosrcspektimittërregiillavetëligjit tëpunësimitosetëpunës.

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE
SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.4

Kerkes sipas dosjes se tenderit 2.3 Një(1) inxhinier i Dip. i gjodezis me licenc -min.3vite përvojë pune pas diplomimit në angazhimet profesionale
OEi rekomanduar si fitues nuk I plotëson kushtet te kjo kërkesë sepse thuhet kjartë qe Inxhinjer I dip.i gjeodezisëti ket 3 vite përvoj pune pas diplomimit diploma qe e kan ofruar Arjana Kadolli Gashi shihet kjart qe diplomën apo Titullin Master e ka marrur me datën 16.07.2018 ndërsa tenderi qe u doriu ka qen data 02.10.2020 qe i bije te mos ketë pervoj pune 3 vjeçare duke ju referuar te dhanave qe kane diplomte Masterit.
Po ashtu I njeti nuk ka kontrat pune te cekur për këtë Project

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE

SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.5

Kërkesa sipas dosjes se tenderit 5. Operatopri ekonomik duhet te kete baze për prodhimit perpunimit te betonit
OE.i rekomanduar si fitues nuk ka ofruar marrveshje siq eshte kerkuar ne FDT. Te dosjes se tenderit ku nuk përmendet emri i OE.Fituese apo Liderit te grupit dhe nuk është cekuar se për cilin tender behet fjale nuk përmban asnje te dhen per kete dosje te tenderit për te cilen kan ofruar nje marrveshje e cila ka qene e përpiluar dhe nënshkruara me date para se mu publiku njoftimi perkontrat 18.09.2020 data e nehskrimit te marrveshjes11.03.2020 me ketë date kjo marrëveshje nuk i plotson kete kriter te FDT –se dhe nuk përmendet Titulli i tenderit as nr. I Prokurimit.

KERKOJM NGA OSHP QE TA ANALIZOJ KETE PRETENDIM TONE
SHIKO DESHMIT E BASHKANGJITURA NR.6

Per operatoret tjere ekonomik qe ishin pjesmmarres ne kete procedur te prokurimit sipas vlersimit te komisionit te vlersimit dhe ZPP"N.N.T"ETNIKU" "INTACT SH.P.K.": "ALB-DG SH.P.K. ,Pajtohemi me te gjeturat e tyre per mos plotsim te kritereve apo kushteve te FDT te dosja e tenderit te ciletjane cekur ne letren standarde per OE te eliminuar.

Demet material AL-BER

Perpergatitjen e ketij tenderit jane ber shpenzime te konsiderueshme.Gjithashtushperblimi me kontrate i nje grupi te operatoreve ekonomik te papaergjegjeshm do te na pamundesojnfitimine e kesaj kontrate te cielen keni llogatitur shpenzimet mujore perpuntore dhe shpenzimet tjera si dhe fitimin per kryerjen e keti projekti

Demet material VISAR KUCI B.I.

Gjate pregatitjes se ofertes(TENDERIT) Komletimi i dokumentacionit qertifikatave dokumentacion i ndryshemetj
Jan krijuar shpenzime ne vlere prej 5000.00 €
2.Kompletimi i stafit dhe angazhimi i tyre ne pregatitje te ofertesjane krijuar shpenzime ne vlere prej 2500.00 €
3.Gjate pregatitjes se kerkuesesperryshqyrtim dhe ankesave tjera jane krijuar shpenzime ne vlere prej 2000.00 €

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e kërkuara nga AK-ja (për pretendimet qe ka OE ankues):

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertësë OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- **N/A**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:
OE."AL-BER"SHPK.- Suharekë

Pergjigje ne pretendimet ankimore te OE.së ankuese AL-BER SHPK.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se konzorciumi ka ofertuar si Operator ekonomik dhe jo si konzorcium, mendoj se edhe krijimi i grupit është qe një anëtar te mbështet me dokumente anëtarin tjetër dhe oferta e konzorciumit duhet te dorëzohet si konzorcium dhe jo si operator.
Pra, mendoj se nuk përmbushet kriteri i kërkuar sepse ne moment qe behet krijimi i grupit edhe oferta duhet te dorëzohet ne grup.

Operatoret ekonomik duhet te jene te regjistruar ne platforme qe dosja me pastaj te dorëzohet gje qe është obligim ligjor për krijimin e konzorciumit.

Sa i përket pretendimit kryesor te OE,ankues se Konzorciumi –grupi i operatoreve qe është propozuar ti jepet kontrata nuk e ka ka ngarkuar ofertën ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit janë pjesërisht te bazuara

sepse vërtet OE, "AAB CONSTRUCTION" e ka ngarkuar ofertën vetëm si operatore ekonomik individual ne vete kurse ne dosjen e ngarkuar ka bashkangjitur edhe marrëveshjet e formimit te grupit te operatoreve. Rregullat e formimit te grupit dhe te dorëzimit te ofertava jane te përcaktuara ne RRUOPP,ne piken 27 po ashtu kjo çeshtje është e rregulluar edhe nenin 71 te LPP-se.
Unë mendoj se oferta e OE,qe është propozuar për kontratë i ka plotësuar shumicën e kritereve te thekura ne RRUOPP, dhe ne LPP-ne mirëpo e vetmja pike qe nuk është respektuar këtu është pika 11.1 e përcaktuar ne Dosjen te tenderit Tek FLETA E TE DHANAVE TE TENDERIT ,ku thuhet citoj :
Të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të regjistruar në platformën elektronike të KRPP-s dhe tenderin duhet ta dorëzojnë përmes platformës në grup.
Këtu mendoj se e vetmja pike qe i jepe te drejt OE,ankues është ajo qe thotë se Tenderin duhet ta dorëzojnë përmes platformës ne grupë, qe ne këtë rast tenderi është dorëzuar si një operator ekonomik individual , kjo shihet ne ofertën e ngarkuar,ne procesverbalin e hapjes se tenderëve, dhe ne raportin e vlerësimit.

Pretendimi ankimor ne këtë pike është pjesërisht i bazuar.

AK duhet te respektoj nenin 59 te LPP-se sipas kritereve te vendosura ne Njoftim per kontrate dhe ne dosjen e tenderit, ku respektimi i këtij neni nuk bie ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se (barazia ne trajtim/jo diskriminimi).

*Pra, ne **paragrafin 1 te këtij neni thuhet :"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë nëmënyrë transparente"***

Është përgjegjësi dhe obligim i AK-se qe ti respektoj kriteret e vendosura ne FDT dhe Njoftim për kontrate.

Pergjigjeje ne pretendimet e ankimore të OE,së Ankues "VISAR KUÇI B.I."NTP."THESARI"

Pergjigje nr.1
Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues nr.1.CV. e inxhinierve te pa nenshkruara

Lidhur me pretendimin ankimor te OE,se Ankuese se është eliminuar nga ky tender sepse CV.e inxhinierëve kan qene te pa nënshkruar është i pa bazuar ankesa sepse edhe ne Njoftimin për Kontratë edhe ne Dosjen e Tenderit tek Kapaciteti teknik dhe Profesional TE dëshmit dokumentare thuhet : Lista e stafit te punëtorëve dhe inxhinierëve te O.E. origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. -Diplomat e inxhinierëve (kopje e noterizuar), -CV-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje e noterizuar) Për gjeodetin-Kopja e noterizuar e licencës.
Pas shiqimit te dokumentaconit te inxhinierve eshte vërejtur se CV-te janë te pa nënshkruara, sepse edhe RRUOPP,pika 39.8 konform nenit 72 dhe 59 te LPP-se te shembujt e kërkesave për sqarim te tenderit **thuhet**

:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Ne mendojmë se ne këtë rast CV-ja e dorëzuar nuk i ka përmbushur kërkesat ashtu siç ka kërkuar AK-ja sepse kërkesa e AK-se ishte CV-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri, prandaj mendoj se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Pergjigje nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor se OE ka cmime me te shtrenjta

Sa i perket ketij pretendimi pas analizimit te paramases, ofertes financiare te OE,se AAB Construction dhe OE.qe ka permendur ne ankesën e tij OE.Ankues, konkretisht ofertes se ***INTACT SHPK*** ku shihet se shumica e pozicioneve qe i ka OE.AAB CONSTRUCTION jane me te shtrejt se OE, I Theksuar ne kete ankesë,si shembull po u a sjellim disa nga pozicionet ne Pune përgatitore dhe Demoluese.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

PARAMASA DHE PARALLOGARIA - PUNIMET NDERTIMORE

Objekti: Aneks ndertimi i shkolles fillore ne Mamushe
Faza e parë-ndertimi i vrazhdët

Nr.	Pershkrimi i punimeve	njësia	sasia	çm.njësi	shuma
	PUNET PERGATITORE DHE DEMOLUESE				
1.1	Inqizimi i terenit dhe caktimi i pikave per pregatitjen e punishtes per pune. Logaritetë----------komplet	komplet	1	4500	4,500.00€
1.2	Pastrimi i terenit dhe pregatitja per lokimin dhe fillimin e germimit per nivelimin e terenit per ndertimin e shkolles. Logaritetë----------komplet	komplet	1	4500	4,500.00€
1.3	Demolimi i objektit ekzistuesëThemele+Perdhesa+kulmi E ndertuar me materiale te fortaNe çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte.(dimens. 13.0mx30.0m)	komplet	1	2500	2,500.00€
1.4	Demolimi i kubzave ekzistuese , ne çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte.	m2	164	0.2	32.80€
1.5	Demolimi i fushes ekzistuese te futbollit me asfalt dhe pjeset tjera perberese , rrethojen, tribunen prej betoni , ne çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte.	m2	539	15	8,085.00€
1.6	Rrethimi i punishtes perkohesisht deri ne perfundimin e puneve per sigurin e punes dhe vijimine pandarpre te mesimit ne shkollen ekzistuese.Ne kete pozic.te parashihet edhe zhvendosja e furnizimit elektrik ne skaj te situacionit. Logaritetë----------komplet	komplet	1	250	250.00€
	Gjithsejt punet pergatitore				19867.8
	PUNET E DHEUT				
2.1	Germimi dhe pastrimi i terenit t=20.0cm per largimin e humusit nga siperfacja e parapare per ndertim. Ketu parashihet edhe transporti i dheut deri ne deponine largesi max.5.0km nga vendpunishtja. Logaritet ne ----------m³	m³	700	1	700.00€
2.2	Germimi i gjere i dheut te kategorise III & IV me makine, per hapjen e themeleve shiritore .Ekzekutuesi i punimeve duhet te kete parasysh gjate kalkulimit te parashihet edhe ngjeshja e terenit . Ne çmim duhet llogaritur edhe largimin e materialit te germuar deri ne deponi max.5.0km largesi nga punishtja.	m³	285	1	285.00€

INTACT SHPK

Page 1

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA

PARAMASA DHE PARALLOGARIA - PUNIMET NDERTIMORE

Objekti: Arenka ndertimi i shkolles fillore ne Mamushe
Faza e pare-ndertimi i vrazhdët

Nr.	Pershkrimi i punimeve	njesia	sasia	cm.njesi	shuma
I	PUNET PERGATITORE DHE DEMOLUESE				
1.1	Inojzmi i terenit dhe caktimi i pikave por pregatitjen e punishtes per pune. Logaritëte----------komplet	komplet	1	6000	6,000.00€
1.2	Pastrimi i terenit dhe pregatitja per lokimin dhe fillimin e germimit per nivelimin e terenit per ndertimin e shkolles. Logaritëte----------komplet	komplet	1	6000	6,000.00€
1.3	Demolimi i objektit ekzistuesë Themelo+Perdhesa+kulmi E ndertuar me materiale te forta ne çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte (dimens. 13.0mx30.0m)	komplet	1	3500	3,500.00€
1.4	Demolimi i kubzave ekzistuese , ne çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte.	m2	164	1	164.00€
1.5	Demolimi i fushes ekzistuese te futbollit me asfalt dhe njeset tjera perbese , mothojen, tribunen prej betoni , ne çmim perfshihet edhe transportine deponi per materiale inerte.	m2	539	10	5,390.00€
1.6	Realizimi i punishtes perkohesisht deri ne perfundimin e puneve per sigurin e punes dhe vjelrine panderprer te mesimit ne shkollen ekzistuese.Ne kete poziz te paraqitet edhe zhvendosja e furnizimit elektrik ne skaj te situatës. Logaritëte----------komplet	komplet	1	220	220.00€
	Gjithsejt punë përgatitore				21274.6
II	PUNET E DHEUT				
2.1	Germimi dhe pastrimi i terenit t=20.0cm per larginin e humusit nga siperfaqja e parapare per ndertim. Keto paraqitet edhe transporti i dheut deri ne deponine largesi max.5.0km nga vendpunishtja. Logaritet me ----------m³	m³	700	2.5	1,750.00€
2.2	Germimi i gjere i dheut te kategorise III & IV me makina, per hapjen e themeleve shiritore. Ekzekutimi i punimeve dohet te kete parasyh gjatë kalkulimit te paraqitet edhe njësisë e terenit. Ne çmim duhet llogaritur edhe larginin e materialit te germuar deri ne deponi max.5.0km largesi nga punishta.	m³	285	2.5	712.50€

Page 1

AAB Construction sh.p.k. PRISHTINE

Pra siq shihet ne kete pozicione por edhe ne shume pozicione tjera si tek Punët e Betonit dhe Armaturës OE,AAB CONSTRICTION ka çmim me te lart se OE, i përmendur ne këtë ankesë ,OE,AAB CONSTRUCTION te betonimi i themeleve ka çmim per njesi prej 55.00 € apo ne total 15,675.00 ,kurse OE,I përmendur ne këtë ankesë ne këtë pozicion ka çmim pernjesi prej 45.00 € apo ne total 12,825.00 €,prandaj OE, i rekomanduar për kontrate nga AK-ja ka çmime me te larta .
Pergjegjesia e AK-se eshte te beje vërtetimin e çmimeve te OE se rekomanduar me çmimet e tregut.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

Pergjigje nr.3
Lidhur me pretendimin ankimor se paramasa e OE.AAB Construction nuk eshte e vulosur dhe nënshkruar.
Lidhur me këtë pretendim edhe këto nuk qendojn sepse siç shihet ne paramasen e OE,AAB CONSTRICTION ,te gjitha pozicionet ne fund ku eshte kerkuar nënshkrimi dhe vula janë te vulosura dhe nënshkruara te gjitha tek Rikapitullimit e

përgjithshëm aty ku është kërkuar nenshkrimi dhe vula e OE,se qe e plotëson ofertën financiare-paramasen dhe parallogarin. Si shembull po ua bashkangje si me poshtë :

Siç shihet edhe ne shembullin e lartcekur paramasa dhe parallogaria jane te vulosura dhe nënshkruara nga operatori ekonomik AAB CONSTRUCTION:

	mbajtëse me dërrasë 2mm dhe e mbrojtur me ngjyrë të plastifikuar, me dimensione 1700x700x250mm				
4.1.1.2	Furnizimi dhe montimi i ndërprerës trepolare me aftësi shkyqëse 16 kA dhe rryma nominale të mbrojtjes 60A/63A. Ndërprësi ka mbrojtje termike dhe termomagnetike.	copë	2	30.00	60.00
4.1.1.3	Furnizimi dhe montimi i ahkarkuesve të mbitensionit ZNO 0.5kV, 40kA, 4p.	copë	1	40.00	40.00
4.1.1.4	Materiali i imët përcjellës për lidhje (zbarra, përques P/F, papuqe, kleme, bulona, etj.)	Paushall	1	220.00	220.00
			Gjithsej 4.1 :		570.00
4	REKAPITULIMI I PUNËVE ELEKTRIKE				
4.1	Kuadrot Shpërndarëse				570.00
4	GJITHSEJT PUNËT ELEKTRIKE:				570.00

Emri i OE:	"AAB CONSTRUCTION" SHPK
Adresa e plotë:	Rr.Luan Haradinaj Sol 1 Hyrja 1 Nr4 - Prishtinë
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe Mbiemri:	Arlind Buzhala
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	02.10.2020
Vula:	"AAB-Construction" sh.p.k. PRISHTINË

Pergjigje nr.4

Lidhur me planin dinamik se nuk i plotëson kushtet ashtu siç i ka kërkuar AK-ja.

Lidhur me kete pretendim ankimor AK-Ne dosje te tenderit dhe ne Njoftim per kontrate AK-Ka kerkuar qe OE , siq thuhet ne dosje te tenderi: Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 45 (Dyzet e pesë) ditë pune nga data e marrjes së urdhërblerjës nga Autoriteti Kontraktues.

Ky pretendim ankimor është i pabazuar sepse OE,I Rekomanduar ka dorzuar planin dinamik me data konkrete ashtu siq eshte kerkuar ne dosje te tenderit dhe ne Njoftim per Kontratë

Mendoj se ne kete pikë ,Kriter te përcaktuar ne dosje te tenderit ,OE,AAB CONSTRUCTION ,ka dorezuar planin duke ju permbajtur afati kohor qe mos te jete me shume se 45 ditë ,por se ka bere leshime sepse nuk ka dorezuar planin detal te realizimit te punimeve sipas pozicioneve te theksuar ne paramas dhe para llogari,,por se AK,Nuk ka kerkuar plane dinamik detal por vetem qe plani dinamik te mos jete me shume se 45 dite pune.

Pergjigje nr.5

Lidhur me çmimet jo normalisht te ulta ne disa pozicione.

Lidhur me këto pretendime ankimore mendoj se nuk qendrojn se vertet pas shiqimit te paramses se dorëzuar nga OE,Ankues dhe krahasimit me çmimet e dorëzuar nga OE,I Rekomanduar janë çmime me te ultë tek punët e betonit dhe armatures ,porse AK-i ka kërkuar sqarime shtese OE,serekomandur, kjo deshmi gjendet ne platrofmen e prokurimit elektronik.

AK-me letër për sqarimin e tenderi jo normalesh te ulet qe e ka te ngarkuar ne platformë me dt.20.10.2020,ka kërkuar informacione shtese ,dhe kësaj letre OE, i Rekomanduar i është përgjigjur brenda 2 ditëve duke i dhene sqarime e nevojshëm,sqarime këto qe gjenden te ngarkuar ne platform.

Prandaj ky pretendim mendoj se nuk qëndron sepse po te shikohen me detaje te gjitha pozicionet ne paramas OE,Ankues ne pozicionet e Punëve përgatiture dhe Demoluese pozicionet 1.1,1.2.,13 ,jane me çmim pernjesi

prej 1500.00. €,secila kurse OE,i rekomanduar ka ofruar çmim prej 6000.00 €,perketo pozicione pra çmim për njesi andaj ne baze te këtyre fakteve mendoj se pretendimi ankimor nuk qëndron për çmime jo normalisht te ulta nga OE,I Rekomanduar.

Pergjigje nr.6

Lidhur me inxhinieren e diplomuar te gjeodezis Arijana Kadolli -Gashi

Lidhur me Pretendimin ankimor për këtë inxhiniere , këto nuk qëndron sepse edhe ne Njoftimin për kontratë tek Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: ***Një(1) Inxhinier i Dip. i gjeodezisë me licencë-min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit në angazhimet profesionale.***

Z.Kadolli-Gashi është diplomuar ne Fakultetin e Ndertimtarisë – Drejtimi Gjeodezi ne vitin 2011,ka qen e angazhuar ne matje gjeodezike qe nga viti 2012,gjate viteve 2014-2016 ka punuar si bashkepuntore e jashtme per matje gjeodezike pran kompanisë ***Kosova Asfalt****, po ashtu gjate viteve 2017-2019, ka punuar ne kompanin* ***Kosova Asfalt shpk****, kjo deshmohet me referencat qe i kane lëshuar inxhinieres se lartcekur këto dy operator ekonomik, po ashtu ne vitin 2016 merr licencën nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me te cilën Licencë ,licencohet si gjeodete.*

Po ashtu i ka përfunduar edhe studimet master ne Universitetin Politeknik te Tiranes duke marr titullin Master i shkencave ne Inxhinieri GJEODEZI ne vitin 2018, konkretisht 16.07.2018.

Pra me këto angazhime pas diplomimit mendoj se nuk e plotëson kushtin e kërkuar ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderin te AK-se për Inxhinier i diplomuar me licencim 3 vite përkoj pune ne angazhim profesional, per arsye se 2018 – 2020 jane dy (2) vite, e nuk permbushet kriteri i kerkuar 3 vite pervoje pune.

Pretendimi ankimor i pjeserishem.

Pergjigje nr.7

Lidhur me bazen per prodhimin e BETONIT.

Lidhur me këtë pretendim kriteri i AK-se ishte :Op. Ek. duhet të ketë bazën e vetë për prodhim të betonit ose marrëveshje me njërën nga bazat për prodhim të betonit - furnizuesi me beton duhet të ofroj certifikatën e biznesit dhe licencën për prodhimin e betonit nga KPMM ose autoriteti përgjegjës në vendin e themelimit të O.E.

OE,I rekomanduar për kontrate ,konkretisht parteri i saj NPSH.Bageri ne këtë aktivitet ka marrëveshje për prodhimin e betonit ,e lidhur ndërmjet BAGERI-1 SHPK dhe NPSH.BAGERI ,marrëveshja është e noterizuar nga pronari Bujar Shabani tek noteri Zyfer Aliu ne Lipjan, marrëveshja është lidhur me 11.03.2020 dhe eshtevalide deri me 31.12.2020 kjo marrëveshje e ka te bashkangjitur Certifikatën e Biznesit me informatat shtesë po ashtu edhe Lejen për aktivitete te veçanta i leshura nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e vlefshëm deri me 29.09.2022.

Pra pretendimi i OE,nuk qëndron.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat te aprovohen pjesërisht te bazuara dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA MAMUSHÊ.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP-së
- OE ankues - **OE. "AL-BER "SHPK& VISAR KUÇI B.I. NTP."THESARI"**